



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo za Rad i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Bazuar në nenin 12, paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale:

Shpall Konkurs Publik
për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit:	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Titulli i punës:	Bashkëpunëtor në Zyrën e Pensioneve
Koeficienti	8 (tetë)
Raporton te:	Udhëheqësi i Zyrës së Pensioneve
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Zyra e Pensioneve në Pejë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Merret me hulumtimin e problematikës së pensioneve në rajonin e Pejës;
- Ofron informata dhe ndihmë për publikun me rastin e aplikimit, në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të zyrës së pensioneve;
- Bën analiza për çështjet që ndërlidhen me lajmërimet e pensionistëve;
- Harton raporti mbi gjendjen e përgjithshme;
- Kryen edhe punë të tjera që janë në interes të shërbimit, sipas rekomandimit të udhëheqësve.

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë e tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë universitare;
- 2 vite përvojë pune;
- Të njohë punën me kompjuter;
- Të njohë shkëlqyeshëm gjuhën shqipe dhe serbe në të folur dhe të shkruar.

Emri i Institucionit:	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Titulli i punës:	Zyrtar për Komunitete - i rezervuar për pjestarë të komuniteteve jo shumicë
Koeficienti	7 (shtatë)
Raporton te:	Drejtori i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta – (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Gjashtë muaj
Orari i punës:	I plotë
Numri i ekzekutuesve:	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën hulumtime dhe analiza lidhur me promovimin, avancimin dhe mbrojtjen e komuniteteve dhe ofrimin e mundësive të barabarta brenda institucionit;
- Mbledh të dhëna për përfaqësim të drejtë të komuniteteve dhe ofrimin e mundësive të barabarta në institucion;
- Ndhmon në implementimin e politikave gjithëpërfshirëse të komuniteteve dhe siguron që ato të jenë në pajtueshmëri me standardet evropiane;
- Konsultohet me përfaqësuesit e komuniteteve për të inkurajuar bashkëpunimin mes institucionit dhe shoqërisë;
- Kryen edhe punë të tjera të autorizuara nga udhëheqësi i departamentit.

Shkathtësitë e kërkuara: *(Kualifikimet, përvojat si dhe aftësitë dhe shkathtësitë tjera që kërkohen për këtë vend të punës)*

- Diplomë universitare;
- 2 vite përvojë pune;
- Të njohë punën me kompjuter;
- Të njohë shkëlqyeshëm gjuhën shqipe dhe serbe në të folur dhe të shkruar.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Përzgjedhja bëhet në pajtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 të Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në këtë konkurs zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Divizioni për Burime Njerëzore, Zyra nr. 201, Kati i dytë, Sheshi “Zahir Pajaziti”, ndërtesa e re e MPMS-së në Prishtinë. Aplikacioni mund të shkarkohet nga ueb-faqe <http://mpms-gov.net/>

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore, në numrin e telefonit 038 212-886, prej orës 8:00 – 16:00.

Konkursi mbetet i hapur 5 (pesë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: **22.09.2017** deri më **26.09.2017**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin arsimor, përvoja e punës dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës, për të cilin konkurrohet.

Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë nëpërmjet telefonit.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpret aplikacionet nga të dyja gjinitë dhe të gjitha komunitetet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite Ministry of Labour and Social Welfare

Na osnovu člana 12, stav 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo i Zakon br. 04 /Z-077 o Obligacionim Odnosima, radi pružanja posebnih usluga, Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite :

Objavljuje Javni Konkurs
za Sporazum o Posebnim Uslugama

Naziv Institucije :	Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Naziv radnog mesta :	Saradnik u Penziskoj Kancelariji
Koeficienat	8 (osam)
Izveštava kod :	Rukovodiocu Penzionog Ureda
Vrsta ugovora :	Sporazum o Posebnim Uslugama – (SPU)
Trajanje ugovora	Šest meseci
Radno vreme :	Puno
Broj izvršilaca:	1 (jedan)
Mesto :	Penziskoj Kancelarij u Peć

Zadaci i odgovornosti:

- Bavi se istraživanjem penzijskih pitanja u Pećkoj regiji;
- Pruža informacije i pomoć građanima prilikom aplikacije , u saradnji sa odgovornim službenicima penzionog ureda;
- Analizira pitanja vezana za prijavljivanje penzionera;
- Izrađuje izveštaj o opštoj situaciji;
- Obavlja i druge poslove koji su u interesu usluge, u skladu sa preporukama rukovodioca .

Potrebne veštine: (Kvalifikacije, iskustva i druge veštine i veštine potrebne za ovo radno mesto)

- Univerzitetska diploma
- 2 godine radnog iskustva
- Poznavati rad sa računarom.
- Savršeno znati albanski i srpski jezik na govornom i pisanom jeziku.

Naziv Institucije :	Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite zajednice
Naziv radnog mesta :	Službenik za Zajednice - rezervisano za pripadnike ne vecinske
Koeficienat	7 (sedam)
Izveštava kod :	Direktora Departmana Finansijske i Opste Službe
Vrsta ugovora :	Sporazum o Posebnim Uslugama – (SPU)
Trajanje ugovora	Šest meseci
Radno vreme :	Puno
Broj izvršilaca:	1 (jedan)
Mesto :	Priština

Zadaci i odgovornosti

- Sprovodi istraživanja i analize o promociji, unapređenju i zaštiti zajednica i pružanju jednakih mogućnosti u okviru institucije;
- Prikuplja podatke o pravičnoj zastupljenosti zajednica i pružanju jednakih mogućnosti u instituciji;
- Pomaže u primeni politika u celokupnim politikama zajednica i obezbeđuje da su u saglasnosti sa evropskim standardima.
- Savetuje se sa predstavnicima zajednice kako bi podstakli saradnju između institucije i društva
- Obavlja i drugi ovlašćeni rad od strane rukovodioca departmana .

Potrebne veštine: (Kvalifikacije, iskustva i druge veštine i veštine potrebne za ovo radno mesto)

- Univerzitetska diploma
- 2 godine radnog iskustva
- Poznavati rad sa računarom.
- Savršeno znati albanski i srpski jezik na govornom i pisanom jeziku.

Uslovi učestvovanja na konkursu :

Svi građani Republike Kosova imaju pravo da se prijave, koji imaju punu sposobnost da deluju, imaju građanska i politička prava, imaju neophodnu stručnu spremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje poslova i koji poseduju fizičke veštine potrebne za odgovarajuću poziciju.

Pravni i podzakonski akti koji regulišu zapošljavanje:

Izbor se vrši u skladu sa članom 12 stav 4 Zakona br. 03 / Z-149 Civilne Službe Republike Kosova, Zakon br. 04 / Z-077, o Obligacionim Odnosima. Na ovom konkursu se sprovodi pojednostavljeni postupak zapošljavanja.

Postupci konkurisanja :

Procedura konkurencije je otvorena za spoljne kandidate

Podnošenje aplikacija: Prijem i podnošenje prijave: Divizij za ljudske resurse, II- sprat kancelarija br. 201, trg “Zahir Pajaziti” nova zgrada MRSZ-a u Prištini, aplikacija se može preuzeti sa

<http://mpms-gov.net/>

Za dodatne informacije kontaktirajte Kancelariju Departmana za Ljudske Resurse u MRSZ tel.038 / 212-886 ili od 8:00-16:00 časova.

Konkurs je otvoren **5**(pet) kalendarskih dana od dana objavljivanja ,počevši od **22.09.2017** do **26.09.2017** koji se smatra poslednjim danom zatvaranja konkursa.

Aplikacije poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci od zadnjeg dana roka za aplikaciju će se smatrati važećim i uzet će se na razmatranje, ukoliko pristižu unutar 2 dana, dok aplikacije pristigle nakon isteka roka i one nekompletirane neće se razmatrati. Aplikaciji priložiti kopijedokumenata o kvalifikaciji, iskustvo i drugu potrebnu dokumentaciju koje zahteva radno mesto, za koje se konkuriše. Podnošene aplikacije se ne vraćaju!

Odabrani kandidati u uži izbor će biti pozvani na intervju putem telefona.

Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite pozdravlja prijave iz oba pola i svih zajednica.

